



KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

"Lidhje 3"

RREGULLORE

E

**ZYRËS SË KARRIERËS, TUTORIATIT
STUDENTOR DHE ALUMNI**

(Miratuar me Vendim nr. 1, datë 09.01.2018, të Senatit Akademik)

VLORË, 2018

RREGULLORE E ZYRËS SË KARRIERËS, TUTORIATIT STUDENTOR DHE ALUMN-IT

KREU I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e veprimtarisë administrative të Zyrës së Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumn-it, (ZKTSA), si dhe këshillimin e karrierës së studentëve në përputhje me objektivat e saj.

Këshillimi i karrierës është një proces ndërpersonal projektuar për të ndihmuar individët në çështjet e zhvillimit të karrierës

Neni 2 Baza ligjore

Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, statuti dhe rregullorja e KUPV, janë baza ligjore e kësaj rregulloreje.

Neni 3 Vizioni

Të fuqizojë studentët për të bërë zgjedhje të përgjegjshme dhe të qëndrueshme gjatë gjithë jetës, në një botë globale dhe dinamike.

Neni 4 Misioni

T’u shërbejë nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, të dizajnuara për të lehtësuar të mësuarit dhe avancimin e mirëqenies me qëllim zhvillimin e profesionalizmit, identitetit dhe të qytetarisë.

KREU I DYTË

FUNKSIONI, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 5

Funksioni i zyrës

ZKTSA është struktura përgjegjëse që organizon, menaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj, mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentore, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve. Ajo drejton dhe mbështet në mënyrë të vazhdueshme Këshillin Studentor, i cili është një hallkë e rëndësishme në jetën studentore

Zyra drejtohet nga një koordinator, i cili emërohet nga rektori.

Funksionet kryesore të ZKTSA janë të përcaktuara në rregulloren e Kolegjit Universitar “Pavarësia Vlorë” (KUPV).

Neni 6

Detyrat kryesore

Përvesa parashikohet në rregulloren e KUPV, Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumn-it ka edhe këto detyra:

- Përgatit propozimet për ndryshime dhe përmirësime të programeve mësimore në përgjigje të kërkesave të kandidatëve për studentë dhe të studentëve dhe ia paraqet për miratim strukturave përkatëse.
- Mban marrëdhënie të vazhdueshme me organet e këshillave studentore, shoqatat studentore apo organizime të tjera studentore dhe i mbështet ata në funksionimin e tyre.
- Transmeton tek organet drejtuese të KUPV-së problematikat e ngritura nga studentët në formë të organizuar ose jo.
- Organizon, manaxhon dhe drejton procesin e rekrutimit të studentëve të rinj nga shkollat e mesme.
- Organizon, manaxhon dhe drejton procesin e këshillimit të studentëve në lidhje me procesin akademik në KUPV, studimet dhe çështje të tjera të lidhura me to.
- Organizon dhe koordinon aktivitetet studentore kulturore, sportive, argëtuese, etj, si dhe ato në bashkëpunim me të tretët, në ambientet e KUPV-it dhe jashtë tij.
- Ndjek dhe organizon çështjet e karrierës të studentëve në KUPV.
- Ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në KUPV.
- Mban kontakte të vazhdueshme, grumbullon informacione mbi të diplomuarit, si dhe është përgjegjëse për përgatitjen e librit të karrierës.

Neni 7

Përgjegjësitë

Zyra, përgjigjet edhe për:

- a) Organizimin e panairëve të punës;
- b) Mbajtjen e të dhënave për punësimin e të diplomuarve;
- c) Ndjekjen e punësimit të të diplomuarve.
- d) Këshillimin e studentëve të KUPV-së që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, në KUPV ose universitete të tjera, të vendit dhe të huaja;
- e) Këshillimin e studentëve të KUPV-së që diplomohen në nivelin e parë dhe të dytë për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si edhe mundësitë e punësimit në tregjet rajonale dhe më gjerë;
- f) Koordinimin dhe monitoron realizimin e procesit mësimor në ambientet e KUPV;
- g) Informimin e studentëve dhe publikut të interesuar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në KUPV;
- h) Pritjen e aplikantëve dhe studentëve të rinj;
- i) Shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentëve të rinj;
- j) Ndjekjen e ecurisë së studentëve të pranuar;
- k) Përgatitjen e guidave dhe fletëpalosjeve orientuese për studentët e vitit të parë;
- l) Dhënien e informacionit të nevojshëm për programet dhe kurrikulat e studimeve;
- m) Dhënien e informacionit për diplomat që ofron KUPV.

Neni 8

Bashkëpunimi me struktura të tjera

ZKTSA për realizimin e misionit të saj bashkëpunon edhe me struktura të tjera. Ajo:

- a) bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të KUPV-it.
- b) mban komunikim me tregun e punës për të tërhequr mendime sa i takon përputhjes së diplomave të ofruara me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave.
- c) mban marrëdhënie të vazhdueshme me shoqatat apo organizime të tjera të Alumn-it dhe i mbështet ato në funksionimin e tyre.
- d) ndihmon studentët në krijimin e lidhjeve me punëmarrësit potencialë.
- e) shërben si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione dhe të ofrojë shërbime trajnimi për biznese të ndryshme.
- f) në bashkëpunimin me strukturat drejtuese të KUPV, fakulteteve, departamenteve dhe stafit akademik e ndihmës-akademik, ofron për studentët: workshope; trajnime; info day; takime të hapura, etj.

KREU I TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9
Interpretimi i rregullores

Të drejtën për interpretimin e kësaj rregulloreje e ka rektori i KUPV. Në rast të mosarritjes të një interpretimi, e drejta e interpretimit i kalon rektoratit dhe Senatit Akademik.

Për të gjithë situatat të cilat nuk gjejnë përgjigje në këtë rregullore, vihen në zbatim dispozitat e përcaktuara në statutin dhe në rregulloren e KUPV.

Neni 10
Hartimi, përmirësimi dhe miratimi i rregullores

Rregullorja hartohet nga Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumn-it dhe shqyrtohet në Asamblenë e personelit akademik, dhe në Këshillin Studentor.

Kjo rregullore është objekt i përmirësimit të vazhdueshëm. Përmirësimet mund të propozohen nga strukturat akademike, sektorët administrative e mbështetës, këshillat e studentëve, etj. Ndryshimet apo shtesat duhet të synojnë përmirësimin e rregullave ekzistuese apo plotësimin me rregulla të reja për situata që nuk janë normuar nga kjo rregullore, por që janë objekt i saj. Ndryshimet e propozuara në këtë rregullore miratohet në Senatin Akademik të KUPV-së.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “Pavarësia Vlorë”.